

VENDIM
Nr. 233, datë 21.3.2017

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË
ANGAZHIMIT PËR ZHVILLIMIN E
TREGUT TË GAZIT DHE
MARRËVESHJES PËR PËRFITIMET
VENDASE, TË LIDHURA NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, E CILA
VEPRON NËPËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, DHE TRANS ADRIATIC
PIPELINE AG, LIDHUR ME PROJEKTIN
E GAZSJELLËSIT TRANS ADRIATIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të
nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet
ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me

propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë,
Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së angazhimit për
zhvillimin e tregut të gazit dhe marrëveshjes për
përfitimet vendase, të lidhura ndërmjet Republikës
së Shqipërisë, e cila vepron nëpërmjet Këshillit të
Ministrave, dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur
me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik, sipas
tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren
Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

MARRËVESHJE E ANGAZHIMIT PËR ZHVILLIMIN E TREGUT TË GAZIT
1.3.2017
**NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË QË VEPRON NËPËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE DHE TRANS ADRIATIC PIPELINE AG NË LIDHJE ME PROJEKTIN E**

GAZSJELLËSIT TRANS ADRIATIK

HYRJE

KJO MARRËVESILJE E ANGAZHIMIT PËR ZHVILLIMIN E TREGUT TË GAZIT (Marrëveshja) është lidhur në qytetin e Tiranës në Republikën e Shqipërisë, në [...] [...] 2017

NDËRMJET:

- (1) **REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (Shteti)** që vepron nëpërmjet Këshillit të Ministrave; dhe
- (2) **TRANS ADRIATIC PIPELINE AG**, një shoqëri e organizuar dhe që ekziston në bazë të ligjeve të Zvicrës, me degë të regjistruar në Shqipëri në adresën ABA Business Centre, Zyra Nr. 906, Rruga Papa Gjon Pali II, Tiranë, E regjistruar në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit në Tiranë me Nr. regjistrimi K92402023O (Investitori i Projektit, dhe së bashku me Shtetin, referohen si Palët).

DUKE PASUR PARASYSH SE:

- (A) Palët kanë hyrë në një marrëveshje me qeverinë e vendit pritës (MQP) në datën 5 Prill 2013 në lidhje me Projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti), e cila është ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar më 15 Prill 2013 dhe që është ndryshuar në ose rreth datës së sotme nëpërmjet nënshkrimit Marrëveshjes për Ndryshimin e MQP-së ndërmjet Palëve, ndryshim i cili i nënshtrohet ratifikimit nga Parlamenti Shqiptar.
- (B) Në lidhje me MQP-në, Palët kanë hyrë në një marrëveshje krahasuese më 5 Prill 2013 (Marrëveshja Krahasuese), e cila është ratifikuar nga Parlamenti shqiptar më 15 Prill 2013, e cila, ndër të tjera, përcakton bazën mbi të cilën Palët do të bien dakord të negociojnë dhe të finalizojnë një Marrëveshje të Angazhimit për Zhvillimin e Tregut të Gazit (siç përcaktohet në Marrëveshjen Krahasuese).
- (C) Kjo Marrëveshje është Marrëveshja e Angazhimit për Zhvillimin e Tregut të Gazit që referohet në pikën (B) më sipër dhe pranohet që përbën një Marrëveshje Projekti për qëllime të MQP-së. Kjo Marrëveshje është ligjërisht detyruese për Palët.
- (D) Më 15 nëntor 2013 Investitori i Projektit ka marrë një vendim pozitiv për ndërtimin e Projektit dhe, kështu, nuk ka asnjë kusht tjetër në lidhje me detyrimin për të nënshkruar, ose hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje në bazë të paragrafit (e) të nenit 3 (Angazhimi për Zhvillimin e Tregut të Gazit) të Marrëveshjes Krahasuese.
- (E) Investitorit të Projektit i kërkohet nga parashikimet e Përgjashtimeve Rregullatore për të kryer testime të tregut në mënyrë të herëpashershme, duke filluar nga jo më vonë se Data e Operimit Tregtar, me qëllim përcaktimin e kërkesës së palëve të treta për akses në Sistemin e Gazsjellësit. Të gjitha palët e interesuara mund të marrin pjesë në këto testime të tregut dhe të marrin një alokim të kapacitetit në Sistemin e Gazsjellësit në përputhje me udhëzimet dhe procedurat e miratuara nga autoritetet kombëtare rregullatore të energjisë në Shqipëri, Greqi dhe Itali.

PALËT NË KËTË MARRËSHJE KANË RËNË DAKORD si më poshtë:

1. Marrëveshja Krahasuese

- (a) Nëpërmjet nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, Palët pranojnë që kanë përmbushur të gjitha detyrimet e tyre të parashikuara në nenin 3 (Angazhimi për Zhvillimin e Tregut të Gazit) të Marrëveshjes Krahasuese siç detajohet më tej edhe në aneksin 1 të së njëjtës marrëveshjeje dhe që asnjë detyrimin tjetër në lidhje me këtë nen 3 nuk do të lindë në të ardhmen.

- (b) Referencat e Angazhime TG në këtë Marrëveshje i referohen Angazhimeve TG përkatëse dhe numrave që u janë alokuar atyre, te parashikuara në aneksin 1 të Marrëveshjes Krahasuese.
- (c) Kjo Marrëveshje përbën të gjithë marrëveshjen ndërmjet Palëve në lidhje me objektin e nenit 3 (Angazhimi për Zhvillimin e Tregut të Gazit) të Marrëveshjes Krahasuese dhe aneksit 1 të saj dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet, masat apo mirëkuptimet e mëparshme në lidhje me të.

2. Data e Hyrjes në Fuqi dhe Afati

- (a) Kjo Marrëveshje hyn në fuqi pasi:
 - (i) kjo Marrëveshje nënshkruhet nga Palët;
 - (ii) kjo Marrëveshje miratohet nga Këshilli i Ministrave; dhe
 - (iii) Marrëveshja Krahasuese zgjidhet në përputhje me Nenin 4 të Marrëveshjes për Ndryshimin e MQP-së të referuar në pikën (A) më sipër.
- (b) Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën që nënshkruhet nga të dyja Palët dhe do të vazhdojë të jetë në fuqi deri në:
 - (i) datën në të cilën të gjithë detyrimet e Palëve të parashikuara në të janë përmbushur;
 - (ii) datën në të cilën MQP nuk do të jetë më në fuqi dhe efekti i plotë; dhe
 - (iii) datën në të cilën Palët bien dakord me shkrim që ta zgjidhin atë.

3. Studimi i Fizibilitetit – Angazhimet 1,2 dhe 3

Pranohet që Studimi i Fizibilitetit i referuar në Angazhimet TG 1, 2 dhe 3 është plotësuar dhe financiar, dhe që detyrimet e Investitorit të Projektit në lidhje me këto Angazhime TG janë përmbushur në mënyrë të plotë. Për këtë arsye, nuk parashikohet asnjë dispozitë tjetër në këtë Marrëveshje në lidhje me Angazhimet TG 1, 2 dhe 3.

4. Pika Fillestare Dalëse Shqiptare – Angazhimi TG 4

- (a) Angazhimi TG 4 i referohet detyrimit të Investitorit të Projektit për të projektuar, prokuruar dhe ndërtuar pajisjet për reduktimin e presionit dhe pajisjet matëse në një pikë të vetme dalëse të pranuar (Pika Fillestare Dalëse Shqiptare ose PFDS) nga Sistemi i Gazsjellësit për në rrjetin shqiptar të shpërndarjes së gazit dhe/ose linjat e drejtpërdrejta të lidhjes dhe/ose rrjetin e përcjelljes, me kusht që në asnjë rast kapaciteti minimal për Pikë Fillestare Dalëse Shqiptare të mos jetë nën 0.3 BCM në vit.
- (b) Për të përmbushur në mënyrë të plotë Angazhimin TG 4, Investitori i Projektit duhet të projektojë, prokurorë dhe ndërtojë PFDS-në në sistemin e kompresimit të Investitorit të Projektit që do të vendoset në ose pranë qytetit të Fierit.
- (c) Pavarësisht kapacitetit minimal të referuar në Angazhimin TG 4, Investitori i Projektit duhet të sigurohet që PFDS ka kapacitet të përshtatshëm për të mbuluar kërkesën për Gaz Natyror në qarkun e Fierit, i cili është treguar sipas pëlqimit të Investitorit të Projektit nga Shteti, deri në një maksimum prej 0.6 BCM në vit, minus shumën sipas të cilës kërkesa e treguar bie deri në 0.3 BCM në vit. Pa cenuar detyrimin e përgjithshëm të Investitorit të Projektit sipas paragrafit (b) më sipër, nëse PFDS plotësohet para Datës së Operimit Tregtar, kjo kërkesë duhet t'i tregohet Investitorit të Projektit jo

më vonë se në datën 1 Korrik 2017. Për këto qëllime, do të çmohet që është vërtetuar mjaftueshëm kërkesa sipas pëlqimit të Investitorit të Projektit, nëse Shteti paraqet të gjitha sa më poshtë:

- (i) letrat e synimit të nënshkruara nga marrësit e Gazit Natyror ku përcaktohen sasi të Gazit Natyror që pritet të merret, i cili do të shpërndahet nëpërmjet PFDS-së;
- (ii) planet e ndërtimit ose angazhimet për ndërtime në lidhje me infrastrukturën ndërlidhëse ndërmjet TAP-it dhe marrësve përkatës të Gazit Natyror; dhe
- (iii) konfirmim nga konsumatorët përkatës që shpërndarja e sasisë që ata do të marrin do të jetë në përputhje me kushtet e mëposhtme të shpërndarjes:
 - (A) presioni i shpërndarjes do të jete ndërmjet 10-16 bar (g);
 - (B) rrjedhja/sasia minimale do të jetë 20,000 Sm³/orë dhe
 - (C) rrjedhja/sasia maksimale do të jetë 80,000 Sm³/orë,

apo çdo kusht tjetër që mund të jetë njoftuar paraprakisht nga Investitori i Projektit në lidhje me vërtetimin e kërkesës kur kapaciteti bie nën 0.3 BCM në vit.

- (d) Nëse një kërkesë e tillë për Gaz Natyror nuk vërtetohet brenda datës 1 Korrik 2017, Investitori i Projektit duhet të përmbushë detyrimet e tij të parashikuara në paragrafin (b) më sipër brenda 28 muajve pas vërtetimit të kërkesës sipas pëlqimit të tij.
- (e) Investitori i Projektit duhet të zhvillojë dhe ndërtojë PFDS-në në përputhje me standardet e parashikuara në MQP, duke përfshirë standardet teknike të përdorura për projektimin dhe ndërtimin e Sistemit të Gazsjellësit.
- (f) Pranohet se angazhimi i Investitorit të Projektit për projektimin, prokurimin, financimin dhe ndërtimin e PFDS sipas kësaj Marrëveshje është një detyrim i ndarë dhe i veçantë nga çdo detyrim tjetër që Investitori i Projektit mund të ketë në përputhje me kushtet dhe afatet e Përfashtimeve Rregullatore, duke përfshirë por pa u kufizuar në detyrimin në lidhje me ndërtimin e pikës së daljes me dy drejtime sipas kërkesave të këtyre kushteve dhe afateve.

5. Trajnimi – Angazhimi PV (d)

- (a) Angazhimi PV (d) i referuar në Anëksin 2 të Marrëveshjes Krahasuese kërkon që Investitori i Projektit të marrë masa për zgjerimin e kapaciteteve të partnerëve kombëtarë në Shqipëri dhe të ofrojë mundësi të rritjes ekonomike në Shqipëri, në çdo rast duke forcuar trajnimin profesional dhe trajnimin teknik në lidhje me gazin dhe edukim tjetër të lidhur me tubacionet.
- (b) Për përmbushjen e plotë të këtij detyrimi, Investitori i Projektit merr përsipër të investojë një shumë totale prej 700,000 Euro në trajnim dhe edukim, në mënyrë që t'i japë mundësinë shoqërive, organizatave dhe individëve të ndërtojnë aftësi mbi standardet ndërkombëtare teknike dhe industriale në fusha të lidhura me zhvillimin infrastrukturor dhe shërbimet në mbështetje të zhvillimit ose operimit/mirëmbajtjes infrastrukturor.
- (c) Investimi i referuar në paragrafin (b) më sipër duhet të kryhet në mënyrë të plotë jo më vonë se në Datën e Operimit Tregtar.
- (d) Investitori i Projektit duhet t'i japë Shtetit njoftim paraprak me shkrim për çdo investim të propozuar duke dhënë arsyet për zgjedhjen e investimit të propozuar, ku çdo njoftim i tillë me shkrim duhet të

jetë në formën e materialeve për tu lexuar para takimit për takimin e radhës të konsultimit dhe progresit tremujor, siç përcaktohet në paragrafin (e) më poshtë.

- (c) Investitori i Projektit do të monitorojë dhe vlerësojë veprimtarinë e organizatave që zbatojnë objektivat e përmendura në këtë Pikë 5 në mënyrë të vazhdueshme, me qëllim për të siguruar që këto objektiva janë arritur dhe përveç kësaj ai:
- (i) do t'i sigurojë Shtetit përditësime në lidhje me këto objektiva gjatë takimeve të konsultimit dhe progresit tremujor, takime të cilat do të zhvillohen në Tiranë, me njoftim të arsyeshëm të dhënë nga Shteti për Investitorin e Projektit;
 - (ii) në çdo takim të tillë, të përfshijë një prezantim të programit të ardhshëm të trajnimit dhe edukimit për të cilin propozon të investojë, me qëllim arritjen e këtyre objektivave;
 - (iii) përgatisë një raport vjetor të aktiviteteve të tij të trajnimit dhe edukimit dhe të publikojë raportin në faqen e tij të internetit, duke përfshirë edhe tekstin e plotë të ndonjë auditimi të çdo pale të tretë (për të cilat është në dijeni) mbi aktivitetet e tij në lidhje me objektivat e përmendura në këtë Pikë 5; dhe
 - (iv) sipas kërkesës, do të lehtësojë aksesin për përfaqësuesit e Shtetit (si vëzhgues) në çdo program të trajnimit dhe edukimit për të verifikuar progresin e tij dhe tu sigurojë të gjitha dokumentet financiare që evidentojnë investimin e kryer.

6. Huaja e butë për zhvillimin e OST-së

- (a) Përveç Angazhimeve TG, me kërkesë me shkrim të shtetit, Investitori i Projektit do të prokurojë një agjenci shumëpalëshe kreditimi e cila do të japë hua apo ai vetë do të japë hua, shumën e principalit prej 6,300,000 Euro për operatorin e sistemit të transmetimit (OST) që do të vendoset në lidhje me transmetimin e gazit natyror në Shqipëri si një hua që do të jepet në përputhje me kushtet e përcaktuara në formën e marrëveshjes së huasë në Shtojcën 1.
- (b) Investitori i Projektit, pas një njoftimi prej 60 ditësh të dërguar nga Shteti, duhet të nënshkruajë një marrëveshje të tillë huaje me OST-në, përveç nëse në atë kohë TAP ka prokuruar një agjenci shumëpalëshe kreditimi, e cila do të japë huanë e përmendur në paragrafin (a) më sipër dhe që është e gatshme për të nënshkruar marrëveshjen e huasë në atë formë.

7. Përgjegjësia e Palëve

Asnjë nga Palët nuk do të jetë përgjegjëse ndaj Palës tjetër për Humbje apo Dëmtime të çfarëdo lloji, qoftë ato të shkaktuara në zbatimin e apo në lidhje me këtë Marrëveshje, përveç:

- (i) për Humbje ose Dëmtim të shkaktuar nga pakujdesia e rëndë e asaj Pale, shkeljeve të qëllimshme, mashtrimeve apo akteve të paligjshme; ose
- (ii) në rastin e Investitorit të Projektit, për Humbje ose Dëmtim që rezultojnë nga mospërbushja e detyrimit për të kryer një paradhënie të huasë në përputhje me kushtet e marrëveshjes së huasë të nënshkruar nga Investitori i Projektit, të referuar në nenin 6,

por në asnjë rast Investitori i Projektit nuk do të ketë ndonjë detyrim ndaj Shtetit për asnjë Humbje ose Dëmtim që rezultojnë nga instalimi ose operimi i PFDS-së (siç përcaktohet në Nenin 4).

8. Përfaqësime dhe garanci

- (a) Shteti kryen përfaqësime dhe garancitë e përcaktuara në:

- (i) paragrafët (b) dhe (d) të pikës 12.1 (Përfaqësimet dhe Garancitë e Shtetit) të MQP-së në datën e kësaj Marrëveshjeje; dhe
- (ii) paragrafët (a) dhe (e) të pikës 12.1 të lartpërmendur në datën e kësaj Marrëveshjeje dhe i përsërit ato përfaqësimet dhe garanci në çdo ditë më pas,

në çdo rast, duke iu referuar fakteve dhe rrethanave që kanë ekzistuar në atë kohë dhe njëjloj sikur referencat tek MQP janë referenca tek kjo Marrëveshjeje.

(b) Investitori i Projektit kryen përfaqësimet dhe garancitë e përcaktuara në:

- (i) paragrafët (a) dhe (c) të pikës 13.1 (Përfaqësimet dhe Garancitë e Investitorit të Projektit) të MQP-së në datën e kësaj Marrëveshjeje; dhe
- (ii) paragrafët (b) dhe (d) të pikës 13.1 në datën e kësaj Marrëveshjeje dhe i përsërit ato përfaqësimet dhe garanci në çdo ditë më pas,

në çdo rast, duke iu referuar fakteve dhe rrethanave që kanë ekzistuar në atë kohë dhe njëjloj sikur referencat tek MQP janë referenca tek kjo Marrëveshjeje.

9. Ligji rregullues

Kjo Marrëveshje dhe të gjithë të drejtat dhe detyrimet jashtëkontraktuale që rrjedhin nga ose në lidhje me të do të rregullohen nga Ligji anglez.

10. Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

- (a) Çdo mosmarrëveshje, pretendim, mos pajtim ose konflikt që rrjedh nga, lidhet me apo që ka çfarëdolloj lidhjeje me këtë Marrëveshje, duke përfshirë çdo mosmarrëveshje në lidhje sa ekzistencën, vlefshmërinë, interpretimin, zbatimin, shkeljen ose zgjidhjen apo pasojat e pavlefshmërisë së saj dhe çdo mosmarrëveshje që lidhet me ndonjë detyrim jo-kontraktual që rrjedh nga ose në lidhje me të (me qëllim të kësaj klauzole 13, referuar si Mosmarrëveshje) do t'i drejtohet dhe zgjidhet në mënyrë përfundimtare me arbitrazh sipas Rregullave të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (për qëllime të këtij Neni 13, referuar si Rregullat).
- (b) Pavarësisht nga sa më sipër, Palët bien dakord që në lidhje me çdo Mosmarrëveshje që rrjedh nga kjo Marrëveshjeje:
 - (i) në qoftë se një Mosmarrëveshje është pjesë e një mosmarrëveshjeje më të gjerë sipas MQP-së, atëherë një Mosmarrëveshje e tillë, në përputhje me rregullat, do të konsolidohet si pjesë e çdo arbitrazhit të MQP-së në DHNT, me kusht që arbitrazhi i MQP-së të ketë filluar i pari dhe që një gjykim i tillë të përcaktohet nga vetë Gjykata.
 - (ii) për të gjitha Mosmarrëveshjet e tjera që rrjedhin nga kjo Marrëveshjeje (duke përfshirë edhe ato që nuk janë të konsoliduara në përputhje me nenin 13 (b) (i), Palët bien dakord që Mosmarrëveshjet e tilla do t'i referohen dhe zgjidhen në mënyrë përfundimtare me arbitrazh sipas Rregullave në përputhje me këtë Nen 13.
- (c) Rregullat përfshihen me anë të referencës në këtë nen dhe termat me germa të mëdha të përdorura në këtë nen, të cilat nuk janë përkufizuar ndryshe në këtë Marrëveshjeje, kanë kuptimin që u është dhënë atyre tek Rregullat.

- (d) Numri i arbitrave do të jetë një. Në përputhje me nenin 12 (3) të Rregullave, Palët bashkërisht do të emërojnë Arbitrin e Vetëm për konfirmim nga Gjykata e DIINI-së. Secila Palë bie shprehimisht dakord dhe jep pëlqimin për këtë procedure të emërimit dhe caktimit të Tribunalit të Arbitrazhit.
- (e) Selia ose vendi ligjor i arbitrazhit do të jetë në Vjenë dhe gjuha e përdorur në procedurën e arbitrazhit do të jetë anglishtja. Kjo marrëveshje për arbitrazhin rregullohet nga ligji anglez.
- (f) Dërgimi i çdo Kërkese për Arbitrazh në përputhje me këtë nen duhet të kryhet në adresën e secilës Palë në këtë Marrëveshje:

(i) Shteti

Adresa: Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Bulevardi Dëshmorët e Kombit 1001 Tiranë, Shqipëri

Faks: +355 4 2234 052

E-mail: sekretaria@energji.gov.al

Në vëmendje të: Ministrit

(ii) Investitori i Projektit

Adresa: Trans Adriatic Pipeline AG, Lindenstrasse 2, 6340 Baar, Zvicër

Faksi: +41 41 747 34 01

E-mail: tap.dcc@tap-ag.com

Në vëmendje të: Drejtorit Menaxhues

11. Te Ndryshme

- (a) Termat me gërma të mëdha të përdorura në këtë Marrëveshje, të cilat nuk janë përkufizuar ndryshe, do të kenë kuptimin që u janë dhënë në MQP.
- (b) Rregullat e interpretimit dhe ndërtimit të përcaktuara shprehimisht në MQP do të zbatohen, *mutatis mutandis*, edhe për këtë Marrëveshje.
- (c) Dispozitat e nenëve 36 (Heqja dorë nga imuniteti), 44 (Natyra e Detyrimeve të Palëve), 45 (Pasuesit dhe drejtëmarrësit e lejuar), 48 (Njoftimet) dhe 49 (Te Ndryshme) (përveç pikave 49.2 dhe 49.5) të MQP-së zbatohen për këtë Marrëveshje sikur të ishin parashikuar në mënyrë të plotë në këtë Marrëveshje, përveç që referencat tek MQP duhet të interpretohen si referenca tek kjo Marrëveshje.
- (d) Asnjë ndryshim apo amendim i kësaj Marrëveshjeje nuk do të jetë detyrues për Palët, përveç nëse bëhen në formë të shkruar dhe të shprehur për të ndryshuar këtë Marrëveshje dhe nënshkruhen nga përfaqësuesit e autorizuar të secilës prej Palëve.
- (e) Çdo Palë do të bashkëpunojë me Palën tjetër dhe do të veprojë në mirëbesim për të përmbushur detyrimet e saj dhe për të ndihmuar në përmbushjen dhe përparimin në kohë të detyrimeve të Palës tjetër.
- (f) Asgjë në këtë Marrëveshje nuk krijon të drejta që janë të zbatueshme për ndonjë palë të tretë.
- (g) Kjo Marrëveshje nuk do të modifikohet ose ndryshohet nëse nuk bëhet dakord dhe nënshkruhet me shkrim nga të dyja Palët.
- (h) Kjo Marrëveshje do të nënshkruhet në të dyja versionet në gjuhën angleze dhe shqipe. Në rast të ndonjë mospërputhjeje midis këtyre versioneve, versioni në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

ANEKSI 1

FORMA E MARRËVESHJES SË HUASË

Kjo marrëveshje huaje (kjo Marrëveshje) lidhet sot më [] 2017 ndërmjet:

TRANS ADRIATIC PIPELINE AG, një shoqëri e organizuar dhe që ekziston në bazë të ligjeve të Zvicrës, me degë të regjistruar në Shqipëri në adresën ABA Business Centre, Zyra Nr. 906, Rruga Papa Gjon Pali II, Tiranë, e regjistruar në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit në Tiranë me Nr. regjistrimi K924020230 (Huadhënësi); dhe

[Të dhënat e OST-së] (Huamarrësi).

BIHET DAKORD SI MË POSHTË:

Huadhënësi bie dakord t'i japë një hua (Huaja) prej 6,300,000 Euro Huamarrësit në përputhje me kushtet e parashikuara në këtë Marrëveshje në lidhje me aktivitetet e propozuara të Huamarrësit si operator i sistemit të transmetimit dhe në lidhje me [Marrëveshja Shqiptare e Mirëmbajtjes të datës [] ndërmjet Huamarrësit dhe Huadhënësit (Marrëveshja e Mirëmbajtjes)]/[nënkontrata e datës [] ndërmjet Huamarrësit dhe ofruesit të shërbimeve të mirëmbajtjes sipas Marrëveshjes Shqiptare të Mirëmbajtjes të datës [] (Nënkontrata e Mirëmbajtjes)].

Termat e përkufizuara në marrëveshjen me qeverinë pritëse (MQP) të datës 5 Prill 2013 në lidhje me Gazsjellësin Trans Adriatik, të cilat nuk janë përkufizuar ndryshe këtu kanë të njëjtin kuptim kur përdoren në këtë Marrëveshje.

1. Paradhëniet

- (a) [Në bazë të Nenit 4 (Pagesat sipas Nënkontratës së Mirëmbajtjes)], paradhëniet e huasë do të bëhen në Euro pas një njoftimi paraprak prej 30 ditësh me shkrim nga Huamarrësi për Huadhënësin.
- (b) Vlera totale nga paradhëniet e bëra nuk duhet të kalojë 6,300,000 Euro.
- (c) Nuk do të bëhet asnjë paradhënie pas përvjetorit të pestë nga Data e Operimit Tregtar.
- (d) Asnjë sasi e Huasë e cila është kthyer apo parapaguar nuk mund të kryhet më vonë.

2. Interesi

- (a) Interesi do të rritet çdo ditë mbi shumën e paguar të principalit të Huasë në vlerë prej zero për qind në vit, ose në qoftë se është më e madhe, shkalla e përqindjes në vit që është norma minimale e nevojshme, në mënyrë që Huaja të kualifikohet si hua për qëllime statutorc ose rregullatorc, dhe do të jetë e pagueshme nga Huamarrësi më [31 mars dhe 30 shtator] të çdo viti.
- (b) Huamarrësi, sipas zgjedhjes së tij, mund të zgjedhë të paguajë interesin në natyrë me anë të kapitalizimit të interesit, ku interesi i kapitalizuar në këtë mënyrë do të shtohet në shumën e paguar të principalit të Huasë. Shtesa të tilla në shumën e paguar të principalit të Huasë nuk do të trajtohen si paradhënie për qëllime të paragrafit 1 (b) më sipër.

3. Shlyerja

- (a) Në datën (Data e Shlyerjes) e cila është dhjetë vjet pas Datës së Operimit Tregtar, Huamarrësi duhet të shlyeje shumën e papaguar të principalit të Huasë në mënyrë të plotë, së bashku me çdo interes të llogaritur.
- (b) Huamarrësi, herë pas here sipas zgjedhjes së tij, mund të kryejë shlyerje të plota ose të pjesshme të shumës së principalit të papaguar të Huasë pa prim apo penalitet. Çdo parapagim i tillë duhet të kryhet së bashku me interesin e llogaritur për këtë shumë të papaguar. Huamarrësi duhet t'i japë Huadhënësit [] ditë njoftim me shkrim para se të kryejë ndonjë parapagim sipas këtij paragrafi (b).

4. Pagesat sipas [Marrëveshjes së Mirëmbajtjes/Nënkontratës së Mirëmbajtjes]

[Opsioni (1) përfshin, nëse ofruesi i shërbimit të mirëmbajtjes është një sipërmarrje e përbashkët e painkorporuar në të cilën Huamarrësi është palë, ose është një ndërmarrje e përbashkët e inkorporuar në të cilën Huamarrësi zotëron aksione ose nëse Huamarrësi është i vetmi ofruer i shërbimit të mirëmbajtjes sipas marrëveshjes kryesore shqiptare të mirëmbajtjes ose]

Pranohet që Huadhënësi, herë pas here sipas zgjedhjes së tij, mund të mbajë në burim pagesat e kërkueshme dhe të pagueshme sipas Marrëveshjes së Mirëmbajtjes, në përputhje me nenin [] të Marrëveshjes së Mirëmbajtjes. Për çdo shumë të mbajtur në këtë mënyrë, shumat e detyruara nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje do të reduktohen proporcionalisht, ku një reduktim i tillë do të aplikohet në fillim kundrejt interesit të llogaritur (i pakapitalizuar) dhe më pas kundrejt shumës së papaguar të principalit të Huasë në atë kohë.]

[Opsioni (2) përfshin rastin kur Huamarrësi është një nënkontraktues sipas marrëveshjes kryesore shqiptare të mirëmbajtjes

Nuk do të bëhet asnjë paradhënie e Huasë nëse dhe derisa:

- i. Huamarrësi ia ka transferuar të drejtat e tij për të marrë pagesa sipas Nënkontratës së Mirëmbajtjes Huadhënësit në kushte të pranueshme për Huadhënësin; dhe
- ii. Pala tjetër e Nënkontratës së Mirëmbajtjes bie dakord për t'i kryer pagesat në bazë të një nënkontrate të tillë drejtpërdrejt Huadhënësit deri në momentin që Huadhënësi e njofton se të gjitha shumat e detyrueshme sipas kësaj Marrëveshjeje janë paguar në mënyrë të plotë dhe nuk ka shuma të mëtejshme që mund të bëhen të pagueshme në bazë të saj.

Për çdo pagesë të tillë të kryer nga pala tjetër, shumat e detyruara nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje do të reduktohen proporcionalisht, ku një reduktim i tillë do të aplikohet në fillim kundrejt interesit të llogaritur (i pakapitalizuar) dhe më pas kundrejt shumës së papaguar të principalit të Huasë në atë kohë.]

5. Qëllimi

Huamarrësi mund t'i përdorë të ardhurat e çdo paradhënieje të Huasë vetëm për:

- i. të kryer investime të cilat janë të lidhura ekskluzivisht me përbushjen e [detyrimeve të tij sipas Marrëveshjes së Mirëmbajtjes]/[detyrimet e tij sipas Nënkontratës së Mirëmbajtjes] duke përfshirë, pa kufizim, burime të ndërtimit, trajnimit dhe certifikimit; dhe/ose

- ii. [Deri në një shumë maksimale prej Euro []¹,] për zhvillimin, blerjen dhe mbajtjen e burimeve njerëzore, teknike dhe fizike që janë të nevojshme për të përmbushur detyrimet e operatorit të sistemit të transmetimit, siç përshkruhet në Direktivën 2009/73 të Parlamentit Evropian dhe të Këshilli të datës 13 Korrik 2009 në lidhje me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror dhe shfuqizimin e Direktivës 2003/55/KF, por duke përjashtuar shpenzimet e kapitalit në lidhje me infrastrukturën e shpërndarjes dhe transmetimit të tubacionit.

6. Preferimi

- (a) Në bazë të paragrafit (b) më poshtë, Huadhënësi do të lidhë herë pas here dokumente të tilla që janë të nevojshme për të vënë detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje në radhë preferimi pas detyrimeve të Huamarrësit ndaj çdo pale të tretë huadhënëse, në masën që është e nevojshme për të mundësuar që Huamarrësi të marrë hua nga ajo palë e tretë.
- (b) Huadhënësit nuk do t'i kërkohet sipas paragrafit (a) që të jetë palë e ndonjë dokumenti [i cili do të pengonte apo ndalonte përmbushjen e detyrimeve të pagesës në bazë të Marrëveshjes së Mirëmbajtjes] / [i cili do të pengonte transferimin e, apo pagimin drejtpërdrejt tek Huadhënësi, të shumave të detyrueshme sipas Nënkontratës së Mirëmbajtjes] dhe reduktimin e shumave të detyrueshme sipas kësaj Marrëveshjeje siç parashikohet në paragrafin 4 më sipër.

7. Dhënia e Informacionit

Investitori i Projektit mund ta zbulojë këtë Marrëveshje:

- i. për zyrtarët, drejtorët, punonjësit, këshilltarët profesionalë, audituesit ose huadhënësit e tij (dhe këshilltarët e tyre);
- ii. për aksionarët e tij dhe zyrtarët, drejtorët, punonjësit dhe këshilltarët profesionalë apo audituesit e tyre;
- iii. kur është e kërkueshme ose kërkohet nga ndonjë gjykatë e juridiksionit kompetent ose ndonjë organ kompetent gjyqësor, qeveritar, mbikëqyrës ose rregullator; ose
- iv. kur kërkohet nga ligjet ose rregulloret e çdo vendi me juridiksion mbi veprimtaritë e tij.

8. Ligji i Zbatueshëm dhe Juridiksioni

- (a) Kjo Marrëveshje dhe çdo detyrim jo-kontraktual që rrjedhin nga ose në lidhje me të rregullohen nga ligji anglez.
- (b) Gjykatat angleze kanë juridiksion jo-ekskluziv për të zgjidhur çdo mosmarrëveshje në lidhje me këtë Marrëveshje.
- (c) Gjykatat angleze janë gjykatat më të përshtatshme për të zgjidhur çdo mosmarrëveshje të tillë. Huamarrësi bie dakord për të mos argumentuar të kundërtën dhe heq dorë nga kundërshtimi për ato gjykata mbi bazën e forumit të papërshtatshëm, ose lidhur në ndonjë formë tjetër me procedurat që rrjedhin nga kjo Marrëveshje.
- (d) Paragrafët (b) dhe (c) më lart janë në përfitim vetëm të Huadhënësit. Në masën e lejuar nga ligji, Huadhënësi mund të ndër marrë:
 - (i) procedura në ndonjë gjykatë tjetër; dhe

¹ Vini re se kjo shumë nuk do të jetë e njohur derisa diskutimet mbi Kontraten e Mirëmbajtjes do të avancojnë.

- (ii) procedura të njëkohshme në një numër juridiksionesh.
- (c) Referencat në këtë paragraf në një mosmarrëveshje në lidhje me këtë Marrëveshje përfshijnë çdo mosmarrëveshje gjatë ekzistencës, vlefshmërisë ose zgjidhjes së saj.

9. Heqja dorë nga imuniteti

Në përputhje me kërkesat e ligjit shqiptar, Huamarrësi në mënyrë të përvokueshme dhe të pakushtëzuar:

- i. pranon të mos kërkojë ndonjë imunitet nga procedurat e ngritura nga Huadhënësi kundrejt Huamarrësit në lidhje me këtë Marrëveshje dhe siguron se asnjë kërkesë e tillë nuk do të bëhet në emër të tij;
- ii. jep pëlqimin në përgjithësi për dhënien e ndonjë lehtësimit ose lëshimit e çfarëdo procesi në lidhje me këto procedura; dhe
- iii. heq dorë nga të gjitha të drejtat e imunitetit në lidhje me të apo të aseteve të tij.

Kjo Marrëveshje është lidhur në datën e shënuar në fillim të kësaj Marrëveshjeje:

Nga:

Për dhe në emër të

TRANS ADRIATIC PIPELINE AG

si Huadhënësi

dhe

Nga:

Për dhe në emër të

[TË DHËNAT E OST-së]

**NËNSHKRUESIT E MARRËVESHJES SE ANGAZHIMIT PËR ZHVILLIMIN E TREGUT TË
GAZIT**

**KËSHILLI I MINISTRAVE I
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Përfaqësuar nga: Ilir Bejtja

Titulli: Deputy Minister

INVESTITORI I PROJEKTIT

Trans Adriatic Pipeline AG

Përfaqësuar nga: Shkëlqim Bozgo

Titulli: Country Manager

MARRËVESHJE PËR PËRFITIMET VENDASE

1.3 2017

**NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË QË VEPRON NËPËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE DHE TRANS ADRIATIC PIPELINE AG NË LIDHJE ME PROJEKTIN E
GAZSJELLËSIT TRANS ADRIATIK**

HYRJE

KJO MARRËVESHJE PËR PËRFITIMET VENDASE (kjo Marrëveshje) lidhet në Tiranë, në Republikën e Shqipërisë sot në datën [] [] 2017

NDËRMJET:

- (1) **REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË** (Shteti), të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave; dhe
- (2) **TRANS ADRIATIC PIPELINE AG**, një Shoqëri e organizuar dhe që ushtron aktivitetin e saj në përputhje me ligjet e Zvicrës, me degë të regjistruar në Shqipëri në adresën [Qendra e Biznesit ABA, Zyra nr. 906, Rruga Papa Gjon Pali II] Tiranë, e regjistruar pranë Regjistrimit Tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit në Tiranë, me nr. regjistrimi K924020230 (Investitori i Projektit dhe bashkërisht me Shtetin, Palët).

DUKE PASUR PARASYSH SE:

- (A) Palët kanë lidhur një marrëveshje me qeverinë pritëse (MQP) në datën 5 prill 2013 për projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti), i cili është ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar më 15 prill 2013 dhe është ndryshuar në ose rreth datës së sotme nëpërmjet nënshkrimit të Marrëveshjes për Ndryshimin e MQP-së ndërmjet Palëve, ndryshim i cili i nënshtrohet ratifikimit nga Parlamenti Shqiptar.
- (B) Në lidhje me MQP-në, Palët kanë hyrë në një marrëveshje krahasuese më 5 Prill 2013 (Marrëveshja Krahasuese) e cila është ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar më 15 prill 2013 dhe që, ndër të tjera, përcakton bazën mbi të cilën Palët kanë rënë dakord të negociojnë dhe të finalizojnë një Marrëveshje për Përfitimet vendase (siç përcaktohet në Marrëveshjen Krahasuese).
- (C) Kjo marrëveshje është Marrëveshja për Përfitime Vendase që referohet në pikën (B) më sipër dhe pranohet që përbën një Marrëveshje Projekti për qëllime të MQP-së. Kjo Marrëveshje është ligjçrisht detyruese për Palët.
- (D) Më 15 nëntor 2013 Investitori i Projektit ka marrë një vendim pozitiv për ndërtimin e Projektit dhe, kështu, nuk ka asnjë kusht tjetër në lidhje me detyrimin për të nënshkruar, ose hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje në bazë të paragrafit (c) të Nenit 4 (Marrëveshja për Përfitimet Vendase) të Marrëveshjes Krahasuese.

PALËT KANË RËNË DAKORD si më poshtë:

1. Marrëveshja Krahasuese

- (a) Me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, është pranuar se Palët kanë përbushur të gjitha detyrimet e tyre në bazë të nenit 4 (Marrëveshja për Përfitimet Vendase) të Marrëveshjes Krahasuese, siç delajohet më tej në aneksin 2 të kësaj marrëveshjeje dhe se nuk do të lindin detyrime të mëtejshme sipas nenit 4.
- (b) Referencat në këtë Marrëveshje për Angazhimet PV janë referenca të Angazhimeve përkatëse PV dhe numrat e paragrafëve të tyre të referuar në aneksin 2 të Marrëveshjes Krahasuese.
- (c) Kjo Marrëveshje, Marrëveshja Kadastrale e përmendur në Nenin 3 (në rast të Angazhimeve PV (a)) dhe Marrëveshja e Angazhimit për Zhvillimin e Tregut të Gazit të përmendur në Nenin 6 (në rastin e Angazhimeve PV (d)) së bashku përbëjnë të gjithë marrëveshjen ndërmjet Palëve në lidhje me

objektin e nenit 4 (Marrëveshja për Përfitimet Vendase) të Marrëveshjes Krahasuese dhe aneksin e saj 2 dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme, masat ose mirëkuptime në lidhje me të.

2. Data e Hyrjes në Fuqi dhe Afati

(a) Kjo Marrëveshje hyn në fuqi pasi:

- (i) kjo Marrëveshje nënshkruhet nga Palët;
- (ii) kjo Marrëveshje miratohet nga Këshilli i Ministrave; dhe
- (iii) Marrëveshja Krahasuese zgjidhet në përputhje me Nenin 4 të Marrëveshjes për Ndryshimin e MQP-së të referuar në pikën (A) më sipër.

(b) Kjo Marrëveshje do të vazhdojë të jetë në fuqi deri:

- (i) në datën në të cilën të gjithë detyrimet e Palëve të parashikuara në të janë përmbushur;
- (ii) në datën në të cilën MQP nuk do të jetë më në fuqi dhe efekt të plotë; dhe
- (iii) në datën në të cilën Palët bien dakord me shkrim që ta zgjidhin atë.

3. Plotësimi i të Dhënave Kadastrale – Angazhimi PV (a)

Palët pranojnë se Marrëveshja Kadastrale e lidhur ndërmjet Investitorit të Projektit dhe Zyrës Shqiptare të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme më 24 Nëntor 2011, e ndryshuar, përbën një marrëveshje të projektit sipas MQP-së. Palët më tej pranojnë se të gjitha detyrimet dhe angazhimet e Investitorit të Projektit në lidhje me plotësimin e të dhënave kadastrale e siç parashikohet nga Angazhimet PV (a) janë të përfshira në Marrëveshjen Kadastrale dhe për këtë arsye asnjë dispozitë e mëtejshme nuk është e nevojshme sipas kësaj Marrëveshjeje në lidhje me Angazhimin PV (a).

4. Përdorimi i Standardeve Ndërkombëtare – Angazhimi PV (b)

(b) Investitori i Projektit, në kryerjen e aktiviteteve të projektit dhe detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje, duhet të veprojë në përputhje me ligjin përkatës shqiptar. Kërkesat e Performancës të detajuara në Rregulloren Mjedisore dhe Sociale të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe standardet e tjera të përmendura në Pjesën 2 (Standardet Mjedisore, Sociale dhe të Shëndetit Komunitar dhe të Sigurisë) të Aneksit 2 (Standardet) të MQP-së (ato kërkesa të performancës dhe standardet e tjera që përbëjnë Standardet Mjedisore dhe Sociale).

(c) Pranohet që:

- (i) Politikat dhe procedurat mjedisore dhe sistemi i menaxhimit social të Investitorit të Projektit janë zhvilluar për të zbatuar Standardet Mjedisore dhe Sociale dhe për të rregulluar Aktivitetet e Projektit të ndërmarra nga Investitori i Projektit dhe kontraktorët e tij; dhe
- (ii) Investitori i Projektit dhe, në masën e zbatueshme për ta, Kontraktuesit e tij, në ndërmarrjen e këtyre aktiviteteve të Projektit, do të respektojnë dhe do të jenë në përputhje me Standardet Mjedisore dhe Sociale.

5. Përmbajtja Vendase – Angazhimi PV (c)

Investitori i Projektit duhet që, në përputhje me Traktatet e Komunitetit, kërkesat e marrëveshjeve të zbatueshme të Organizatës Botërore të Tregtisë dhe ligjet tjera në fuqi, të sigurojë që rregullat,

procedurat dhe kriteret e kualifikimit dhe vlerësimit (duke përfshirë kërkesat teknike) që ai zbaton për proceset e prokurimit që kryen për qëllim të Aktiviteteve të Projektit, duke përfshirë ato në lidhje me ndërtimin dhe furnizimin e materialeve për Objektet shqiptare, të inkurajojnë përdorimin e punës dhe shoqërive shqiptare në të gjithë zinxhirin e furnizimit të Projektit, duke siguruar se nuk ka diskriminim kundër shoqërive shqiptare dhe, në masën e mundur, Investitori i Projektit do të sigurojë që ofertuesit janë bërë të vetëdijshëm për përfitimet që shoqëritë shqiptare do të ofrojnë në lidhje me Projektin.

6. Trajnimi dhe edukimi profesional dhe në lidhje me gazin – Angazhimi PV (d)

Angazhimi PV (d) kërkon që Investitori i Projektit të marrë masa për zgjerimin e kapaciteteve të partnerëve kombëtarë në Shqipëri dhe të ofrojë mundësi të rritjes ekonomike në Shqipëri në çdo rast, duke forcuar trajnimin profesional dhe trajnimin teknik në lidhje me gazin dhe edukim tjetër të lidhur me tubacionet. Pranohet që të gjitha këto çështje trajtohen sipas pëlqimit të Shtetit në Marrëveshjen e Angazhimit për Zhvillimin e Tregut të Gazit në ose rreth datës së sotme ndërmjet Palëve. Për këtë arsye, nuk është nevojshme për dispozita të mëtejshme sipas kësaj Marrëveshjeje në lidhje me Angazhimin PV (d).

7. Investimet Sociale të Mjedisit dhe përmirësimi i aftësive të Angazhimeve PV (e) dhe (f)

(a) Angazhimet PV (e) dhe (f) kërkojnë që Investitori të ketë në dispozicion fondin për të përmirësuar kushtet e jetesës në komunitetet fqinje dhe biodiversitetit dhe zonës pyjore në dhe rreth habitateve kritike dhe për qëllime të promovimit të një programi të zgjerimit të aftësive për ndërmarrjet shqiptare dhe fuqisë punëtore, për të rritur mundësitë e tyre për të përfituar nga zbatimi i Projektit në Shqipëri.

(b) Për të përmbushur këtë detyrim në mënyrë të plotë, para Datës së Operimit Tregtar Investitori do të investojë ose do të japë angazhime të veçanta për të investuar një shumë totale prej 14,000,000 Euro në projektet e mëposhtme:

- (i) zhvillimin e jetesës;
- (ii) përmirësimin e cilësisë së jetës të komunitetit të vendosur në rrugën ku kalon tubacioni;
- (iii) iniciativa për edukim dhe trajnim; dhe
- (iv) përmirësimi i menaxhimit të mjedisit, duke përfshirë mbështetje për biodiversitetin.

(c) Për qëllimet e paragrafit (b) më sipër, Investitori i Projektit:

- (i) do t'i japë Shtetit njoftim paraprak me shkrim për çdo investim të propozuar, duke dhënë arsyet për zgjedhjen e investimit të propozuar, ku çdo njoftim i tillë me shkrim duhet të jetë në formën e materialeve për tu lexuar para takimit për takimin e rradhës të konsultimit dhe progresit tremujor, siç përcaktohet në paragrafin (d) më poshtë;
- (ii) zgjedhë projektet që mbështesin parimet e SEI-1 të investimeve të Investitorit të Projektit të përcaktuar në Aneksin 1 të kësaj Marrëveshjeje; dhe
- (iii) zgjedhë subjektet për zbatimin e projekteve me anë të një procedure konkurruese tenderi, kur është e mundur.

(d) Investitori i Projektit do të monitorojë dhe vlerësojë veprimtarinë e organizatave që zbatojnë objektivat e përmendura në këtë Nen 7 në mënyrë të vazhdueshme, me qëllim për të siguruar që këto objektiva janë arritur dhe përveç kësaj ai:

- (i) do t'i sigurojë Shtetit përditësime në lidhje me këto objektiva gjatë takimeve të konsultimit dhe progresit tremujor, takime të cilat do të zhvillohen në Tiranë, me njoftim të arsyeshëm të dhënë nga Shteti për Investitorin e Projektit;
- (ii) në çdo takim të tillë, të përfshijë një prezantim të programit të ardhshëm të trajnimit dhe edukimit për të cilin propozon të investojë, me qëllim arritjen e këtyre objektivave;
- (iii) të publikojë një raport vjetor publik në faqen e tij, duke dhënë detajet e aktiviteteve të tij të investimeve sociale dhe mjedisore, përfshirë edhe tekstin e plotë të ndonjë auditimi të çdo pale të tretë (për të cilat është në dijeni) mbi performancën e tij mjedisore dhe sociale në Shqipëri; dhe
- (iv) sipas kërkesës, të lehtësojë aksesin në çdo projekt investimi për të verifikuar progresin e tij dhe të sigurojë të gjitha të dhënat financiare që evidentojnë investimin e bërë.

8. Përgjegjësia dhe përfitimi për autoritetet dhe komunitetet lokale – Angazhimi PV (g)

- (a) Angazhimi PV (g) kërkon nga Investitori i Projektit që tu ofrojë autoriteteve dhe komuniteteve lokale mundësinë për të ndërnarrë përgjegjësi dhe të përfitojnë nga infrastruktura e lidhur me Projektin.
- (b) Pranohet se Investitori i Projektit deri tani ka përfunduar 31 km rrugë dhe 42 ura, secila prej të cilave do të bëhen publike. Më tej pranohet se me botimin e detajeve të këtyre veprave nga Investitori i Projektit në një gazetë kombëtare shqiptare të lexuar gjerësisht, kërkesa e referuar në paragrafin (a) do të jetë përmbushur dhe se Investitori i Projektit nuk do të ketë detyrime më tej në lidhje me Angazhimet PV (g).

9. Përgjegjësia e Palëve

Asnjëra nga Palët nuk do të jetë përgjegjëse ndaj Palës tjetër për Humbje apo Dëmtime të çfarëdo lloji, qoftë të shkaktuara në zbatimin e apo në lidhje me këtë Marrëveshje, përveç:

- i. për Humbje ose Dëmtim të shkaktuar nga pakujdesia e rëndë e asaj Pale, shkeljeve të qëllimshme, mashtrimeve apo akteve të paligjshme; ose
- ii. në rastin e Investitorit të Projektit, për Humbje ose Dëmtim që rezulton nga mospërmbushja e detyrimit për të kryer investimet e parashikuara në Nenin 7 deri në datën e kërkuar nga ai Nen.

10. Praktikat korruptive

(a) Investitori i Projektit:

- (i) konfirmon se për të hyrë në këtë Marrëveshje asnjë nga Drejtorët e tij, punonjës ose përfaqësues nuk janë përfshirë në ndonjë praktikë të korruptuar; dhe
 - (ii) merr përsipër që në kryerjen e detyrimeve të tij sipas ose në lidhje me këtë Marrëveshje nuk do të, dhe duhet të sigurohet se asnjë nga drejtorët e tij, punonjës ose përfaqësues nuk do të, angazhohet në ndonjë praktikë të korruptuar.
- (b) Për këtë qëllim, Praktikë korruptive në kryerjen e detyrimeve të tij sipas ose në lidhje me këtë Marrëveshje, do të thotë dhënia, marrja apo kërkimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo gjëje me vlerë (duke përfshirë por pa u kufizuar në mitmarrje, shpërblime të paligjshme, konfliktet e interesit, grabitje apo shantazh) për të ndikuar në mënyrë të parregullt në veprimet e çdo personi apo për të

nxitur çdo person të mos veprojë në ushtrim të detyrave të tyre, në mënyrë që të sigurojë ose mbajë punën ose për të marrë një p të padrejtë.

- (c) Çdo detyrim nga Investitori i Projektit ndaj palëve të treta në lidhje me Marrëveshjen duhet të kryhet në përputhje me Kodin e Sjelljes të Investitorit të Projektit, i cili është në dispozicion në www.lap-ag.com dhe me legjislacionin anti-korrupsion në fuqi.

11. Përfaqësimet dhe garancitë

- (a) Shteti kryen përfaqësimet dhe garancitë e përcaktuara në:

- (i) paragrafët (b) dhe (d) të pikës 12.1 (Përfaqësimet dhe Garancitë e Shtetit) të MQP-së në datën e kësaj Marrëveshjeje; dhe
- (ii) paragrafët (a) dhe (e) të pikës 12.1 të lartpërmendur në datën e kësaj Marrëveshjeje dhe i përsërit ato përfaqësime dhe garanci në çdo ditë më pas,

në çdo rast, duke iu referuar fakteve dhe rrethanave që kanë ekzistuar në atë kohë dhe njëllor sikur referencat tek MQP janë referenca tek kjo Marrëveshje.

- (b) Investitori i Projektit deklaron dhe garanton parashikimet e përcaktuara në:

- (i) paragrafët (a) dhe (c) të pikës 13.1 (Përfaqësimet dhe Garancitë e Investitorit të Projektit) të MQP-së në datën e kësaj Marrëveshjeje; dhe
- (ii) paragrafët (b) dhe (d) të pikës 13.1 në datën e kësaj Marrëveshjeje dhe i përsërit ato përfaqësime dhe garanci në çdo ditë më pas.

në çdo rast, duke iu referuar fakteve dhe rrethanave që kanë ekzistuar në atë kohë dhe njëllor sikur referencat tek MQP janë referenca tek kjo Marrëveshje.

12. Ligji i Rregullues

Kjo Marrëveshje dhe të gjithë të drejtat dhe detyrimet jashtëkontraktuale që rrjedhin nga ose në lidhje me të do të rregullohen nga Ligji anglez.

13. Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

- (a) Çdo mosmarrëveshje, pretendim, mospajtim ose konflikt që rrjedh nga, lidhet me apo që ka çfarëdolloj lidhjeje me këtë Marrëveshje, duke përfshirë çdo mosmarrëveshje në lidhje me ekzistencën, vlefshmërinë, interpretimin, zbatimin, shkeljen ose zgjidhjen apo pasojat e pavlefshmërisë së saj dhe çdo mosmarrëveshje që lidhet me ndonjë detyrim jo-kontraktual që rrjedh nga ose në lidhje me të (me qëllim të kësaj klauzole 13, e referuar si një Mosmarrëveshje), do t'i drejtohet dhe zgjidhet në mënyrë përfundimtare me arbitrazh sipas Rregullave të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (për qëllime të këtij neni 13, referuar si Rregullat).

- (b) Pavarësisht nga sa më sipër, Palët bien dakord që në lidhje me çdo Mosmarrëveshje që rrjedh nga kjo Marrëveshje:

- (i) në qoftë se një Mosmarrëveshje është pjesë e një mosmarrëveshje më të gjerë sipas MQP-së, atëherë një Mosmarrëveshje e tillë, në përputhje me rregullat, do të konsolidohet si pjesë e çdo arbitrazhit të MQP-së në DIINT, me kusht që arbitrazhi i MQP-së të ketë filluar i pari dhe që një gjykim i tillë të përcaktohet nga vetë Gjykata.

- (ii) për të gjitha Mosmarrëveshjet e tjera që rrjedhin nga kjo Marrëveshje (duke përfshirë edhe ato që nuk janë të konsoliduara në përputhje me nenin 13 (b) (i), Palët bien dakord që Mosmarrëveshjet e tilla do t'i referohen dhe do të zgjidhen në mënyrë përfundimtare me arbitrazh sipas Rregullave në përputhje me këtë Nen 13.
- (c) Rregullat janë përfshirë, duke iu referuar këtij neni dhe termat me germa të mëdha të përdorura në këtë nen, të cilat nuk janë përkufizuar ndryshe në këtë Marrëveshje, kanë kuptimin që u është dhënë tek Rregullat.
- (d) Numri i arbitrave do të jetë një. Në përputhje me nenin 12 (3) të Rregullave, Palët bashkërisht do të emërojnë Arbitrin e Vetëm për konfirmim nga Gjykata e DHNT-së. Secila Palë bie shprehimisht dakord dhe jep pëlqimin për këtë procedure të emërimit dhe caktimit të Tribunalit të Arbitrazhit.
- (e) Selia ose vendi ligjor i arbitrazhit do të jetë në Vjenë dhe gjuha e përdorur në procedurën e arbitrazhit do të jetë anglishtja. Kjo marrëveshje për arbitrazhin do të rregullohet nga ligji anglez.
- (f) Dërgimi i çdo Kërkese për Arbitrazh në përputhje me këtë nen duhet të kryhet në adresën e secilës Palë në këtë Marrëveshje:

Shteti:

Adresa: Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Bulvardi Dëshmorët e Kombit 1001
Tiranë Shqipëri

Faks: +355 4 2234 052

E-mail: sekretaria@energjia.gov.al

Në vëmendje të: Ministrit

Investitori i Projektit:

Adresa: Trans Adriatic Pipeline AG, Lindenstrasse 2, 6340 Baar, Switzerland

Faks: +41 41 747 34 01

E-mail: tap.dcc@tap-ag.com

Në vëmendje të: Drejtorit Menaxhues

14. Të ndryshme

- a) Termat me germa të mëdha të përdorura në këtë Marrëveshje të cilat nuk janë përkufizuar ndryshe do të kenë kuptimin që u është dhënë në MQP.
- b) Rregullat e interpretimit dhe ndërtimit të përcaktuara shprehimisht në MQP do të zbatohen, *mutatis mutandis*, edhe për këtë Marrëveshje.
- c) Dispozitat e neneve 36 (Heqja dorë nga imuniteti), 44 (Natyra e Detyrimeve të Palëve), 45 (Pasuesit dhe drejtëmarrësit e lejuar), 48 (Njoftimet) dhe 49 (Të Ndryshme) (përveç pikave 49.2 dhe 49.5) të MQP-së zbatohen për këtë Marrëveshje sikur të ishin parashikuar në mënyrë të plotë në këtë Marrëveshje, përveç që referencat tek MQP duhet të interpretohen si referenca tek kjo Marrëveshje.